



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE E REVISTËS SHKENCORE  
TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA**

**Miratuar me Vendim Dekanati**

**Nr. 21, datë 07.04.2025**



# **RREGULLORE E REVISTES REVISTËS SHKENCORE**

## **TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Kjo rregullore përcakton bazën ligjore për themelimin dhe veprimtarinë e Revistës Shkencore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH).
2. Kjo rregullore përcakton misionin dhe vizionin, organizimin, procedurat për botim, finansimin e botimit, të drejtat dhe detyrat si dhe kriteret për zhvillimin e veprimtarisë së Revistës Shkencore të FGJH-së.
3. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë modalitetet e pranimit të dorëshkrimeve për botim, të vlerësimit shkencor, procedurat e kontrollit të plagiaturës dhe të botimit të kontributeve shkencore.

#### **Neni 2**

#### **Baza ligjore**

Kjo Rregullore mbështetet në:

Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nenit 117 të Statutit të Universitetit të Tiranës dhe nenit 86 të Rregullores së Universitetit të Tiranës.

#### **Neni 3**

#### **Misioni**

1. Revista Shkencore e FGJH-së, organ shkencor i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ka për mision botimin e prurjeve dhe kontributeve shkencore universitare, në formën e artikujve, akteve të konferencës apo rezultateve të projekteve (eventualisht të tjera) të stafit të saj akademik, studentëve (në Master e Doktoraturë) si dhe studiuesve të tjerë, të IAL-ve vendase apo të huaja që u përgjigjen thirrjeve të saj dhe pranojnë të bashkëpunojnë me këtë revistë.
2. Revista Shkencore e FGJH-së, ka për mision të pasqyrojë zhvillimet dhe arritjet shkencore në fushat dhe disiplinat që ky fakultet mbulon (përkatësisht: didaktikë, letërsi e kulturë, përkthim, gjuhësi e komunikim) duke i dhënë akses një publiku universitar e më gjërë dhe duke mbështetur rritjen e cilësisë së kërkimit dhe të mësimdhënies në FGJH.



## **Neni 4**

### **Vizioni**

Revista synon nxitjen e kërkimit shkencor, promovimin e rezultateve shkencore të kërkimeve apo projekteve e hulumtimeve individuale apo kolektive me standarte të larta, vizualitetin dhe ndarjen e dijes, rezultateve të kërkimit dhe të informacionit shkencor në funksion të ngritisë së cilësisë në auditoret tona dhe më gjërë, për t'i vënë ato në shërbim të shoqërisë.

## **Neni 5**

### **Organizimi dhe struktura e Revistës Shkencore**

1. Revista Shkencore e FGJH-së është një organ botues në shërbim të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja që e zhvillon aktivitetin e saj nën përgjegjësinë e Bordit Shkencor.
2. Revista FGJH ka në përbërjen e saj:

- Bordin Shkencor
- Bordin Editorial
- Drejtorin

## **Neni 6**

### **Bordi Shkencor**

#### **1. Përbërja e Bordit Shkencor**

Bordi shkencor i përbërë nga një numër anëtarësh jo më pak se 5 (pesë) dhe jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë. Ndarja e anëtarëve bëhet për aq sa është e mundur duke ruajtur barazinë e përfaqësimit midis njësive bazë. Kryetar i Bordit dhe anëtar ex officio është zëvendësdekan që mbulon fushën e kërkimit shkencor. Anëtarët e Bordit Shkencor duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë dhe të kategorisë “Profesor”. Zgjedhja e tyre bëhet nga Departamentet dhe i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore.

Anëtarë në Bordin Shkencor mund të jenë dhe anëtarë të personelit akademik të IAL-ve të huaja. Në këtë rast përbërja e Bordit dhe pjesëmarrja e personelit akademik të huaj bëhet në përputhje me marrëveshjen që lidhet me këtë rast.

Anëtarët e Bordit Shkencor dhe të Bordit Editorial, si dhe recensentët paguhen për veprimtarinë që kryejnë në përputhje me aktet që miratohen nga Bordi i Administrimit (neni 117, Statuti i UT-së).

#### **2. Detyrat dhe funksionimi i Bordit Shkencor**



- a. Bordi shkencor mbështet projektin editorial dhe kontribuon në përzgjedjen e dorëshkrimeve, artikujve dhe materialeve të tjera për botim. Anëtarët e Bordit Shkencor e jasin vlerësimin e tyre me shkrim për tekstet (me anë të një recense).
- b. Për ndarjen dhe vlerësimin e teksteve ndiqet procedura *peer review*. Materialet u dërgohen me e-mail anëtarëve të Bordit Shkencor dhe recensentëve të jashtëm duke ruajtur anonimatin e autorëve.
- c. Anëtarët e Bordit Shkencor dhe atij editorial mund të batojnë në revistë në rast se dhe për ta do të zbatohet procedura e redaktimit të fshehtë të dyfishtë (double-blind).
- d. Anëtarët e Bordit Shkencor nuk mund të jasin informacione rreth teksteve të dorëzuara për vlerësim tek asnjë person tjetër përvëç autorit dhe recensuesve.

3. Te drejtat dhe detyrimet e Bordit Shkencor:

- a. Anëtarët e Bordit Shkencor janë edhe recensentë të artikujve dhe kontributeve shkencore. Ata shprehin mendimin e tyre për artikullin që e marrin në mënyrë anonime nga bordi editorial dhe e vlerësojnë sipas një formati, të miratuar paraprakisht nga i gjithë stafi i Revistës *FGJH*. Recensuesit i ofrojnë artikullshkruesit sugjerime për të përmirësuar cilësinë e artikullit, ose mund ta refuzojnë këtë të fundit, kur mendojnë se paraqet probleme të rënda dhe nuk plotëson kriteret e vendosura nga Revista.
- b. Recensentët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe për këtë arsyе nuk duhet të diskutojnë për tekstet me të cilat punojnë për vlerësim me persona të tjerë pa autorizimin e Kryeredaktorit.
- c . Recensentët duhet të shprehin mendimin e tyre për tekstin në mënyrë objektive, të qartë dhe të motivuar.
- d . Recensentët duhet t'i raportojnë Bordit Editorial çdo ngjashmëri materiali ose mbivendosje ndërmjet artikullit në shqyrtim dhe një dokumenti tjetër të publikuar për të cilin ata kanë dijeni.
- e . Recensenti, në pamundësi për të kryer recensën brenda afateve të caktuara nga Bordi Editorial, duhet të njoftojë paraprakisht Bordin Editorial.
- f . Kur recensenti refuzon në mënyrë të përsëritur të bëjë vlerësimin e artikujve të propozuar, ai përjashtohet nga Bordi Shkencor.

## Neni 7

### Bordi Editorial

#### 1. Përbërja dhe detyrat

Ky bord përbëhet nga: drejtori, kryeredaktori, redaktorët shkencorë (1 ose 2), redaktorët.



Numri i anëtarëve të bordit editorial përcaktohet në varësi të nevojave të revistës (por jo më shumë se 4 anëtarë). Ata emërohen (ose shkarkohen) nga Drejtori dhe kontribuojnë, me punën dhe pjesëmarrjen e tyre, në mbarëvajtjen e revistës. Bordi Editorial ka në përbërjen e tij pedagogë të FGJH-së.

Bordi Editorial kryen detyrat e përcaktuara nga kryeredaktori sipas specifikave të revistës.

## **2. Drejtori i përgjithshëm**

Drejtori është autoriteti më i lartë i revistës me të gjitha detyrat që ky rol përfshin. Ai ndjek të gjithë procesin deri në botimin e revistës dhe ndan e mbikqyr punën e stafit përgjegjës.

Në mungesë të tij, punën e anëtarëve të bordit editorial e koordinon dhe e drejton kryeredaktori.

## **3. Kryeredaktori**

Kryeredaktori, punon në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin dhe emërohet nga ky i fundit. Kryeredaktori bashkëpunon me drejtorin dhe anëtarët e tjerë të Bordit Editorial, autorët dhe anëtarët e Bordit Shkencor. Ai kryen gjithashtu funksionet e koordinimit të proceseve të nevojshme për botimin e revistës. Në mënyrë më të hollësishme, kryeredaktori:

- a. Organizon të gjithë punën në revistë dhe bën ndërlidhjen mes bordit editorial e bordit shkencor;
- b. Hap thirrjen për artikuj në bashkëpunim me bordin shkencor;
- c. Ndan detyrat në redaksi dhe mbikqyr realizimin e tyre;
- ç. Në bashkëpunim me redaktorin shkencor përcakton recensentët për procesin e *peer review*;
- d. Mbikqyr dhe miraton materialin përfundimtar të revistës së faqosur, përpala publikimit.

## **4. Redaktori shkencor**

Ai mbështet në detyrat e tij kryeredaktorin dhe kujdeset që revista të realizojë objektivat dhe qëllimin e përcaktuar në misionin e saj në bashkëpunim me Bordin Shkencor dhe atë Editorial.

## **5. Redaktori**

Roli i tij konsiston në publikimin e thirrjes, mbajtjen e kontakteve me artikujshkruesit, koordinimin midis këtyre të fundit dhe anëtarëve të Bordit Shkencor, plotëson detyrat që i cakton kryeredaktori, përgjigjet për redaktimit/korrektimin teknik të artikujve.

## **6. Kompetencat e Bordit Editorial**

1. Bordi Editorial ka këto të drejta dhe detyra:
  - a) Grumbullon punimet;
  - b) Përgatit, koordinon dhe njofton takimet dhe mbledhjet e Bordit Shkencor duke përcjellë paraprakisht rendin e ditës;



- c) Dërgon kopje elektronike dhe fizike të të gjitha materialeve tek çdo anëtar i Bordit Shkencor;
- d) Mban komunikim të rregullt me çdo autor për vendimet e Bordit, duke ruajtur konfidencialitetin e diskutimeve dhe të debateve në mbledhje;
- e) Mban kontakte të rregullta me entet dhe shërbimet e jashtme që realizojnë botimin e kontributave shkencore;
- f) Raporton për tematikat e trajtuara, që të mos të ketë përsëritje të temave dhe problematikës së trajtuar në publikimet pasardhëse.

### **Neni 8**

#### **Detyrat e Autorëve**

1. Kur dorëzojnë një propozim për botim, Autorët duhet të respektojnë rregullat dhe linjën editoriale të publikuara në faqen e internetit të revistës.
2. Autorët duhet të garantojnë etikën në punimin e tyre shkencor, originalitetin e punës së tyre; duhet të tregojnë saktë të gjitha burimet dhe studimet e përdorura; duhet të citojnë saktë veprën dhe/ose fjalët nga autorë të tjera.
3. Autorët duhet të shfrytëzojnë bibliografi të përditësuar.
4. Në artikull duhet të citohen të gjithë ata që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm gjatë procesit kërkimor në fazë të ndryshme të tij: konceptimi, organizimi, realizimi, ripërpunimi, hartimi.
5. Autorët duhet të tregojnë në artikullin e tyre çdo burim financimi për hulumtim dhe/ose projekt që mundësoi në shkrimin e artikullit.
6. Një tekst në proces vlerësimi nuk duhet të paraqitet nga Autori në revista të tjera për publikim.
7. Autorët kanë për detyrë të njoftojnë menjëherë Kryeredaktorin e revistës për ndonjë gabim ose pasaktësi në material, që mund ta kenë konstatuar pas paraqitjes së propozimit, me qëllim tërheqjen e tekstit ose korrigjimet e nevojshme.
8. Autorët duhet të paraqesin dorëshkrime që respektojnë rregullat gramatikore dhe ato ortografike (duke përfshirë shkrimin e saktë të fjalëve me “ç” dhe “ë”)

### **Neni 9**

#### **Standardet e botimit të Revistës**

1. Botimet e artikujve në Revistën Shkencore të FGJH-së realizohen në formate të standardizuara dhe sipas rregullave teknike të miratuara nga Bordi Shkencor.
2. Bordi editorial përcakton standardet, teknikat, cilësinë e materialit të shtypit (letrën, lidhjen, etj.).
3. Çdo botim i Revistës Shkencore të FGJH-së ka në faqet e fundit shënimet e katalogimit të Bibliotekës Kombëtare, si dhe numrin ISSN.



## Neni 10

### Periodiciteti dhe gjuhët e botimit të Revistës

1. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja e boton Revistën Shkencore të FGJH-së së paku dy herë në vit.
2. Artikujt e saj publikohen në gjuhën shqipe ose në një prej gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht ose italisht).
3. Artikujt në shqip të Revistës Shkencore të FGJH-së duhet të kenë detyrimisht një përbledhje në gjuhën angleze, ndërsa ata në gjuhët e tjera duhet ta kenë një përbledhje në gjuhën shqipe.

## Neni 11

### Kriteret formale të revistës FGJH

1. Formati i revistës është **17 X 24 cm (B5 e madhe)**
2. Kopertina është *paper back* (jo *hard copy*) me ngjyra, duke ndryshuar ngjyrat Shkrimi në kopertinë është **Times New Roman 40** për Titullin; **Times New Roman 24** për vitin e botimit dhe numrin rendor të revistës.
3. Në pjesën e sipërme të kopertinës vendoset në krahun e majtë Logo e **Universitetit të Tiranës** dhe në krahun e djathtë Logo e **Fakultetit**.
4. Faqja pas kopertinës të përbajë këto të dhëna:  
Botimi i parë .....  
Fakulteti i .....  
Universiteti i Tiranës  
Adresa: Rr.....  
E-mail: .....  
WWW ....edu.al .....  
Copy right Fakulteti .....  
ISSN .....  
Drejtori .....  
Kryeredaktori .....  
Bordi editorial / Rodaksia .....  
Bordi shkencor .....
7. **Tabela e lëndës** vendoset në fillim të revistës dhe jo në fund të saj.  
Artikujt e përfshirë në të vendosen me rendin e mëposhtëm:  
Titulli i artikullit, emri dhe mbiemri i autorit (bashkëautorëve), me llojin e shkrimit **Times New roman 12**.
8. Shkrimi në brendësi të revistës duhet të jetë **Times New Roman 11** lloji i shkrimit **Times New Roman 10**, shëninet në fund të tekstit.
9. Në faqet **tek** në pjesën e sipërme të revistës do të vendoset titulli i artikullit dhe në **faqet çift** titulli i revistës.



10. Sistemi i citimit do të jetë **Chicago Style**, ose lloje të tjera sistemesh citimi që janë më të përshtatshme me fushat e kërkimit të përfshira në revistë.
11. Revista botohet *on line*, dhe me kopje fizike.
12. Tirazhi përcaktohet në varësi të numrit të artikujve, kërkesave dhe vendimeve të Bordit Editorial.

## Neni 12

### Organizimi i dorëshkrimit

Dorëshkrimi duhet të përmbajë elementet e paraqitura më poshtë.

**Titullin:** Duhet të jetë sa më konciz dhe i qartë.

**Emrat e autorëve:** Duhet të janë të plotë dhe të pasohen nga institucioni ku bën pjesë autori si dhe nga adresa elektronike.

**Fjalët çelës:** Duhet të paraqiten 4-5 fjalë të zgjedhura me kujdes që të pasqyrojnë subjektin e punimit.

**Përbledhjen:** Duhet të paraqesë thelbin e punimit dhe konkluzionet; duhet të jetë rreth 150-200 fjalë. Përbledhja duhet të paraqitet në gjuhën angleze.

**Hyrjen:** Duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur. Duhet gjithashtu të tregohen objektivat, arsyet e ndërmarrjes së studimit si dhe rëndësia e tij.

**Materialet dhe Metodat:** Duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar materialet dhe metodat studimore në të cilën është bazuar studimi. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë rrimmarjen e punimeve të a në të njëjtën fushë.

**Rezultatet dhe Diskutimet:** Rezultatet duhet të janë të qarta dhe të ilustruara në tabela, grafikë (aty ku është e nevojshme) dhe shembuj. Rezultatet e studimit duhet të analizohen statistikisht dhe bazuar në to të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Implikimet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë.

**Përfundimet:** duhet të lidhen direkt me rezultatet e marra. Ato nuk duhet të janë spekulative dhe të përgjithësuara prej literaturës apo njohurive të përgjithshme e spontane.

**Bibliografinë:** Burimet e literaturës duhet të listohen numerikisht në mënyrë alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë. Punimi duhet të përmbajë një numër të arsyeshëm burime literature (15-20). Nëse një burim do të citohet ‘në shtyp’ (in press) do të thotë se ky punim është pranuar për botim. Dorëshkrimet e papranuara për botim nuk mund të citohen. Gjithashtu nuk pranohen referanca nga interneti me përjashtim të botimeve shkencore që bëhen online.

## Neni 13

### Procedura e vlerësimit të punimit



1. Punimet/artikujt për botim do të janë pjesë e një procedure të pavarur të shqyrtimit “blind peer review”. Secili punim ka të paktën dy vlerësues shkencorë. Ky proces do realizohet duke u bazuar në parimin e pavarësisë së vlerësuesve dhe anonimatit të autorëve.
2. Bordi Shkencor i cakton recensentët sipas ekspertizës së tyre në fushën e artikullit. Procesi i vlerësimit merr parasysh faktorë të tillë si rëndësia, rezultatet, analiza, risia dhe përditësimi i literaturës, origjinaliteti, lexueshmëria dhe cilësia e gjuhës. Rezultatet e mundshme të procesit të vlerësimit përfshijnë pranimin, pranimin pas rishikimeve ose refuzimin e punimit.
3. Autori do të informohet për rezultatin e procesit të rishikimit përmes bordit editorial. Pas procesit të suksesshëm të vlerësimit, reflektimit të sugjerimeve dhe miratimit përfundimtar të tekstit nga ana e autorit, punimi i nënshtrohet proceseve parapërgatitore të botimit.

## Neni 14

### Rezultatet e procesit të vlerësimit

1. Recensentët duhet t'i përbahen në mënyrë rigorozë plotësimit të kritereve teknike dhe formale të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Ata ia dërgojnë raportin anonim të vlerësimit me vërejtjet dhe sugjerimet sipas rastit bazuar në formularin e vlerësimit të miratuar nga Bordi Shkencor, i cili gjendet në aneksin e kësaj Rregulloreje.
3. Vendimi që merret si rezultat i procesit të vlerësimit të punimit mund të konsistojë në:
  - a) Punimi pranohet për botim pa ndonjë ndryshim të mëtejshëm të kërkuar nga autorि (ët).
  - b) Punimi pranohet për publikim me disa rishikime të vogla nga autorи (ët).
  - c) Punimi pranohet për publikim me disa rishikime të rëndësishme nga autorи (ët).
  - d) Punimi refuzohet në bazë të "Kushteve për mospranimin e punimeve".
  - e) Punimi refuzohet sepse autor(ët) nuk i është përgjigjur bordit pas dërgimit të komenteve, brenda afateve të caktuara nga Bordi.

## Neni 15

1. Revista Shkencore *FGJH* nuk boton punime që janë botuar të plota nga një entiteti i tjeter botues.
2. Dorëshkrimet nuk merren në konsideratë për botim nëse më parë është botuar më shumë se 30% e tekstit të dorëshkrimit të dorëzuar.

## Neni 16

### Procedura e kontrollit të plagjiaturës



1. Revista Shkencore *FGJH* synon të publikojë punime shkencore/buletine shkencore që ndjekin strukturën e përcaktuar në udhëzuesin për autorët. Plagjiatura dhe autoplagjiatura në çfarëdolloj forme nuk tolerohet. Autorët që paraqesin dorëshkrimet deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre se përbajtja e artikullit është origjinale. Dorëzimi i një punimi nënkupton që autorët marrin përgjegjësinë e plotë për respektimin e kriterieve etike.

2. Revista Shkencore *FGJH* respekton rregullat e vendosura në kuadër të Rregullores së UT-së për “Organizimin e programeve të studimit të doktoratës në Universitetin e Tiranës”, në lidhje me kontrollin e plagjiaturës.

### Neni 17

#### **Financimi i Revistës *FGJH***

1. Revista Shkencore *FGJH* financohet nga fondet e brendshme të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

2. Pas botimit të revistës, çdo autor i jepet një kopje (nga një kopje secilit në rast bashkautorësie); 3 kopje të çdo numri do të depozitohen në bibliotekën e Fakultetit, ndërsa numrat e tjerë mund të dhurohen, të shkëmbohen (në bazë marrëveshjesh) me IAL të tjera, ose të përdoren si materiale në auditore.

### Neni 18

#### **Efekti financiar**

a. Revista nuk do të gjëzojë të ardhura ekonomike; Çdo lloj bashkëpunimi me revistën - intelektual apo material - ofrohet mbi baza totalisht vullnetare dhe pa pagesë.

b. Revista nuk fiton të ardhura nga autorët dhe bashkëpunëtorët. Numrat e revistës ofrohen pa pagesë.

c. Informacionet për revistën janë të shkarkueshme në format digjital nga faqja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dedikuar Revistës Shkencore *FGJH*.

### Neni 19

#### **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

1. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje kujdeset Drejtori i Revistës Shkencore *FGJH*.

2. Kjo Rregullore është e hapur për amendime dhe përmirësimë që e unifikojnë atë me rregullat dhe formatin e miratuar për të gjitha revistat e UT-së.

**DEKAN**

**Prof.Dr. Esmeralda KROMIDHA**

